

AUTORITETI PORTUAL Durrës**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT****1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Autoriteti Portual Durrës
Adresa Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës
Tel/Fax +355 52 70 6 422
E-mail info@durresport.al
Faqja e Internetit www.durresport.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Suzana Mece
E-mail s.mece@durresport.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Hapur e Thjeshtuar (Mallra)- Marrëveshje Kuadër**4. Lloji i Marrëveshjes Kuadër: Mallra (Me një operator ekonomik)****5. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-48345-05-20-2025.****6. Objekti i Marrëveshjes Kuadër: “Blerje pjesë këmbimi për Reachstacker dhe Spreader te Vincave dhe Reachstacker”****7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**

Pjesë këmbimi për motorë 34312000-7

8. Fondi limit: 6.500.000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:
Me datë 23.06.2025 Autoriteti Portual Durrës ka lidhur marrëveshjen kuadër me Nr. 1909 Prot. datë 23.06.2025 me vlerë:**

- 6,302,560 (gjashtë milion e treqind e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh
- 7,563,072 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e dy) lekë me tvsh

me OE “2AS INVEST” Sh.p.k, NIPT/NUIS: NIPT M11803504B

Bazuar në këtë marrëveshje kuadër Autoriteti Portual Durrës ka lidhur 2 kontrata, perkatesisht;

1. Kontrata nr. 2058 date 04.07.2025 sipas listes se kerkuar me vlere: 4,028,700 (kater milion e njëzet e tete mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh dhe 4,834,440 (kater milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e dyzet) lekë me tvsh. Afati i lëvrimit 20 (njëzet) dite nga dita e nënshkrimit.
2. Kontrata nr. 3054 date 01.09.2025 sipas listes se kerkuar me vlere: 2,235,800 (dy milion e dyqind e tridhjetë e pesë mije e tetëqind) pa tvsh dhe 2,682,960 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë me tvsh. Afati i lëvrimit 20 (njëzet) dite nga dita e nënshkrimit.
3. Vlera e mbetur eshte 38,060 leke pa tvsh

Aktualisht ndodhemi në pothuajse në përfundim të ezaurimit të të gjithë vlerës prej 6.264.500 (gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, të marrëveshjes kuadër.

Argumentimi teknik

- Bazuar në Marrëveshjen Kuader nr. 1909 prot., date 23.06.2025 është lidhur kontrata e pare nr. 2058 date 04.07.2025, me anë të së cilës është lëvruar zëri nr.72 për një sasi prej 140 metra lineare “ kabull elektrik super flex 44x2.5 per reachstacker IMHC”, për vincin IMHC 2120/1656
- Aktualisht, në Terminalin e Konteinerëve është konstatuar defekti i kabllit të ushqimit të mjetit IMHC 2120/C1644, i cili është jetik për manovrimin, ngritjen dhe përpunimin e konteinerëve.
- Mungesa e këtij kablli sjell ndërprerje të menjëhershme të operimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në:
 - Zvarritje në shërbimin portual dhe ulje të kapacitetit përpunues;
 - Rritje të kostove operative për shkak të qëndrimit të mjeteve jashtë pune;
 - Rrezik reputacional ndaj operatorëve ekonomikë dhe subjekteve tregtare që përdorin shërbimet e terminalit.
- Aktualisht në terminalin e konteinerëve është duke u operuar vetëm me një vinxh MHC200 i cili ka difekte dhe ky në pjese e parangos, pasi ka konsumuar sistemin e rrotullimit të parangos për shkak të konsumimit çiftit Koron-Pinion.
- Vinxhi IMHC 2120/2 1655 aktualisht nuk punon ka problem me sistemin e motorit pasi fiket gjatë operimit. Duhet të shikohen parametrat nga prodhuesi, pasi ska errore në sistemin e monitorimit.
- Gjithashtu duhet marrë parasysh situata në të cilën ndodhet terminali i Konteinerëve referuar raportit të dispecerise aktualisht të datës 15.09.2025
 - a. 1-MSC Gianna II Shk/Ng. Konteiner për operim në kalat.
 - b. Msc Caledonia II – Shk – 620- Pcs-Konteiner – 12/09-11:45
 - c. -Sc Medford - Shk – 324 –Pcs-Konteiner – 11/09-13:00
 - d. Med Denizli - Shk – 420 – Pcs –Konteiner – 14/10-08:00

Situata është emergjente nëse do të vazhdohet kështu rrezikojmë të shkojmë në pezullimin e punës në terminalin e Konteinerëve.

Nga ana e Sektorit Teknik dhe Operacional janë dërguar disa herë e-mail për të gjetur një zgjidhje emergjente.

Te shikohet mundësia e amendimit të kësaj marrëveshje kuader si rruga e vetme dhe me e shpejte për të kthyer operimin në gjendje normale.

Justifikimi për shtesën e kontratës

- Modifikimi prej 20% synon mbulimin financiar të blerjes së kabllit të ushqimit dhe aksesoreve përkatës, në mënyrë që të garantohet vazhdimësia e shërbimit dhe funksionaliteti operacional i terminalit duke përdorur për përllogaritjen cmimin për njësi të kuotuar në Marrëveshjen Kuader nr. 1909 prot., date 23.06.2025
- Realizimi i shtesës brenda kontratës ekzistuese garanton:
 - Kohëzgjatje minimale të procedurës, duke mundësuar furnizimin në afat rekord;
 - Cilësi të unifikuar, pasi furnizimi kryhet nga i njëjti operator dhe sipas parametrave teknikë të miratuar në kontratë;
 - Shmangie të rrezikut të bllokimit operacional, që do të kishte pasoja të drejtpërdrejta ekonomike për Autoritetin Portual Durrës dhe operatorët tregtarë që bashkëpunojnë.

REKOMANDIMI:

Për sa parashtruar më sipër duke qene se ndodhemi para nevojës emergjente për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit në Terminalin e Konteinerëve , duke konfiguruar një situatë të ngjashme me sa parashikuar në dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, i ndryshuar “Mbi prokurimin publik “pika 1, shkronjat c) ku citohet:

c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër.

Në konkluzion në zbatim të parashikimeve ligjore mbi prokurimin publik rekomandojmë amendimin e marrëveshjes kuadër në vlerën 20% të vlerës së saj pra në vlerën 1.260.512 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) leke pa tvsh.

10. Përshkrimi i modifikimit të Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Amendimi i marrëveshjes kuadër në vlerën 20% të vlerës në shumën prej 1.260.512 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) leke pa tvsh.

Të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër Nr. 1909 Prot. datë 23.06.2025 me objekt “Blerje pjesë këmbimi për reachstacker dhe spreader te vinçave dhe reachstacker”, mbeten të pandryshuara dhe janë të vlefshme dhe për këtë amendament të marrëveshjes kuader.

Ky Amendament marrëveshje kuadër bëhet pjesë integrale e marrëveshjes se sipercituar.

11. Vlera totale e marrëveshjes kuadër së nënshkruar:

Vlera e marrëveshjes kuadër pa tvsh, në lekë ishte: 6,302,560 (gjashte milion e treqind e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Vlera e marrëveshjes kuadër me tvsh, në lekë ishte 7,563,072 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e dy).

12. Vlera e ndryshuar e marrëveshjes kuadër:

Vlera pa tvsh në lekë bëhet: 7,563,072 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e dy).

Vlera me tvsh në lekë bëhet: 9,075,686 (nëntëmilion e shtatëdhjetë e pese mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë)

13. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:12 (dymbëdhjetë muaj) nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër

Dhe afati i ri (nëse është rasti): nuk ndryshon

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

“2AS INVEST” SH.P.K

NIPT/NUIS: NIPT M11803504B

Adresa: Lagjja 13, Plazh, DURRES Zona Kadastrale 8518,Nr.Pasurie 58/338+1-43, kati tete

E-Mail: info@2asinvest.com

Telefon: 0697061832

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: Nr. 3616 Prot., date 06.10.2025

16. Burimi i financimit: Fondet e vetë institucionit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor _____
